

Marrëveshje
në mes të
Qeverisë së Republikës së Austrisë
dhe
Qeverisë së Republikës së Kosovës
mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në çështjet doganore

Qeveria e Republikës së Austrisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, që këtej e tutje do të referohen si “Palët Kontraktuese”,

Duke patur parasysh nevojën e zhvillimit tregtar dhe ekonomik në mes të vendeve;

Të bindur që bashkëpunimi më efektiv në mes të Administratave të tyre Doganore mund të arrihet përmes shkëmbimit të informatave dhe që një shkëmbim i tillë duhet të bazohet në dispozitat ligjore;

Duke patur parasysh që kundërvajtjet ndaj legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat ekonomik, tregtar, fiskal, kulturor, industrial, bujqësor dhe poashtu edhe ato në lidhje me shëndetin publik, ruajtjen dhe sigurinë e vendeve të tyre përkatëse, e gjithashtu edhe tregtinë legjitime;

Duke patur parasysh rëndësinë e sigurimit të vlerësimit korrekt të detyrimeve doganore, taksave ose tatimeve në import ose eksport të mallrave, e poashtu edhe implementimin e duhur të dispozitave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollimin, ku këtë të fundit duke e përfshirë edhe në dispozitat e zbatimit të ligjit dhe rregulloret mbi mallrat e falsifikuara, markat tregtare të regjistruara dhe të drejtën e pronësisë intelektuale;

Të bindur që veprimet kundër kundërvajtjeve doganore dhe përpjekjet për të siguruar grumbullim të saktë të detyrimeve nga importi dhe eksporti, taksave,

pagesave ose tatimeve të cilat mund të mblidhen në mënyrë më efektive përmes bashkëpunimit në mes të Administratave Doganore;

Duke patur parasysh që trafikimi i narkotikëve dhe substancave psikotropike shfaq një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

Duke marrë në konsiderim dispozitat e Konventës së Vetme për Narkotikët të 1961 të plotësuar nga protokollin e vitit 1972 dhe Konventës mbi Substancat Psikotropike të 1971 të hartuar sipas rrethanave të favorshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Substancave Psikotropike më 1988.

JANË PAJTUAR SI NË VIJIM:

Neni 1 PËRKUFIZIMET

Për arsye të kësaj Marrëveshjeje:

1. “Administrata Doganore” do të thotë për Republikën e Austrisë, Ministria Federale e Financave dhe vartësi i saj Autoriteti Doganor; dhe për Republikën e Kosovës, Dogana e Kosovës.
2. “Legjislacioni Doganor” do të thotë çdo dispozitë ligjore dhe administrative e zbatueshme ose e detyrueshme nga Administrata Doganore e Palës Kontraktuese në lidhje me importin, eksportin, tranzitin, magazinimin dhe lëvizjen e mallrave e poashtu edhe mjetet e pagesës qoftë nëse janë të lidhura me detyrimet doganore dhe taksat ose masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit.
3. “Kundërvajtje doganore” do të thotë çdo shkelje ose tentim shkelje e legjislacionit doganor.
4. “Administrata Doganore Kërkuese” do të thotë Administrata Doganore e Palës Kontraktuese, e cila e bën një kërkesë për ndihmë në çështje doganore ose e cila e pranon një ndihmë nga vetë iniciativa e Administratës Doganore.
5. “Administrata Doganore e Kërkuar” do të thotë Administrata Doganore e Palës Kontraktuese, e cila e pranon një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore ose e cila e siguron një ndihmë të tillë me vetë iniciativë.

6. "Informata" do të thotë çdo e dhënë, dokument, raporte, kopje të çertifikuara ose të vërtetuara të tyre ose të komunikimeve tjera, qoftë të kompjuterizuara ose jo.
7. "Të dhënat personale" do të thotë çdo informata në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm.
8. "Narkotikës" do të thotë çdo substancë, natyrale ose sintetike, e radhitur në Listat I dhe II të Konventës së Vetme të Kombeve të Bashkuara mbi Narkotikët të vitit 1961 të plotësuara nga Protokollin e vitit 1972.
9. "Substancat Psikotropike" do të thotë çdo substancë, natyrale ose sintetike ose çdo material natyral i radhitur në Listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi Substancat Psikotropike të Kombeve të Bashkuara të vitit 1971.
10. "Pararendësit" do të thotë substancat kimike nën kontroll që përdoren për të prodhuar drogat dhe substancat psikotropike, që janë të radhitura në Tabelën 1 dhe 2 të bashkangjitura në Konventën e Kombeve të Bashkuara ndaj Trafikimit Ilegal të Narkotikëve dhe Substancave Psikotropike të 20 dhjetorit 1988.
11. "Dërgim i kontrolluar" do të thotë teknika që lejon ngarkesën ilegale ose të dyshimt të narkotikëve, substancave psikotropike ose substancave zëvendësuese të tyre e poashtu edhe mallrave tjera, që konsiderohen të dyshimta për kontrabandë, për të kaluar nëpër ose në territor të Shteteve të Palëve Kontraktuese, me njohurinë ose nën mbikqyrjen e Administratave të tyre përgjegjëse me qëllim të identifikimit dhe zbulimit të personave të përfshirë në trafikimin ilegal të këtyre mallrave.
12. "Kontrolluesi" do të thotë personi fizik ose juridik, autoriteti publik, agjencioni ose ndonjë organ tjetër i cili vetëm ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimin dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 2 FUSHËVEPRIMI I MARRËVESHJES

1. Palët Kontraktuese duhet, përmes Administratave të tyre Doganore dhe në pajtim me dispozitat e caktuara në këtë Marrëveshje, t'i japin njëra tjetrës ndihmë reciproke:
 - a) në mënyrë që të sigurohet zbatimi i duhur i legjislacionit doganor;
 - b) në mënyrë që të parandalohet, hetohet, ndiqet penalisht ose luftohet çdo kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor;

- c) në rastet në lidhje me dërgimin ose njoftimin e vendimeve administrative dhe dokumenteve në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor.
2. Ndihma e cekur në nën paragrafet a) dhe b) të paragrafit 1 të këtij Neni mund të ofrohet në të gjitha masat, qoftë administrative ose gjyqësore, përfshirë edhe hetimet.
 3. Ndihma brenda strukturës së kësaj Marrëveshjeje duhet të jepet në pajtim me legjislacionin në fuqi në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese Kërkuese dhe brenda kompetencave dhe burimeve të Administratës Doganore të Kërkuar.
 4. Ndihma reciproke sipas kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të ndikoj në dispozitat e zbatueshme në lidhje me ndihmën reciproke për çështjet kriminale në mes të Palëve Kontraktuese. Megjithatë, kërkesat për ndihmë në rastet kriminale që bien nën fushëveprimin e kësaj Marrëveshjeje dhe që hetohen nga njëra ose të dyja Administratat Doganore duhet të kryhen brenda kësaj strukture.
 5. Çdo kërkesë për arrestim ose ndalje të personave duhet të përjashtohet nga ndihma sipas kësaj Marrëveshjeje. Grumbullimi dhe mbledhja e detyruar e detyrimeve doganore, taksave tjera, gjobave ose hyrave tjera duhet të përjashtohen nga një ndihmë e tillë.

Neni 3

SHKËMBIMI I PAPLANIFIKUAR I INFORMATAVE DHE BASHKËPUNIMIT

Palët Kontraktuese duhet të ndihmojnë njëra tjetrën, me vetë iniciativë dhe në pajtim me legjislacionet e tyre vendore, nëse e konsiderojnë që është e nevojshme për zbatimin korrekt të legjislacionit doganor dhe vlerësimin të saktë të detyrimeve doganore dhe taksave, në veçanti duke siguruar të gjithë informatat relevante në lidhje me:

- aktivitetet të cilat janë ose duket të jenë kundërvajtëse ndaj legjislacionit doganor brenda territorit të Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese;
- mjetet dhe metodat e reja që përdoren për të kryer një kundërvajtje doganore;
- mallrat që njihen t'i nënshtrohen një kundërvajtjeje të rëndë ndaj legjislacionit doganor;
- mjetet e transportit në lidhje me të cilat ka baza të arsyeshme për të besuar që kanë qenë, janë, ose mund të përdoren në kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor;

- transportimi ndër-kufitar të vlerave monetare në mes të territoreve të Palëve Kontraktuese.

Neni 4 NDIHMA E KËRKUAR

1. Administratat Doganore duhet të ndihmojnë njëra tjetrën në fushat brenda kompetencave të veta, në atë mënyrë dhe sipas kushteve të caktuara në këtë Marrëveshje, për të siguruar që legjislacioni doganor zbatohet në mënyrë korrekte dhe detyrimet e taksat doganore mbliidhen me saktësi.
2. Administratat Doganore duhet që pas kërkesës të sigurojnë çdo informacion i cili tregon që:
 - a) Mallrat dhe vlerat monetare të importuara në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese janë eksportuar sipas ligjit nga territori i Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, duke specifikuar ku është e nevojshme, procedurën doganore e cila është aplikuar për mallrat;
 - b) Mallrat dhe vlerat monetare të eksportuara nga territori i Shtetit të njëjës Palë Kontraktuese janë importuar sipas ligjit në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, duke specifikuar ku është e nevojshme, procedurën doganore të aplikuar për mallrat;
 - c) Mallrat në tranzit kanë kaluar zhdoganimin në territorin e Shtetit të njëjës Palë Kontraktuese.
3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese duhet, nëse nuk është e kundërt me legjislacionin e tyre kombëtar, poashtu të kërkojnë bashkëpunim në:
 - a) Inicimin, zhvillimin ose përmirësimin e programeve specifike trajnuese për personelin e tyre,
 - b) të shkëmbejnë informacione dhe përvoja në lidhje me përdorimin e pajisjeve të reja dhe procedurave.

Neni 5 FORMAT E VEÇANTA TË ASISTENCËS

Administratat Doganore të njëjës Palë Kontraktuese duhet në kërkesë, brenda strukturës së legjislacionit kombëtar dhe kompetencave e aftësive të tyre për të kryer masa të nevojshme vëzhguese në veçanti në lidhje me:

- a) personat e njohur ose të dyshimtë për kryerje ose që kanë kryer kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese;
- b) mallrat që njihen të jenë të dyshimta për trafikim ilegal ose kontrabandim;
- c) mjetet e transportit dhe kontejnerat, që njihen të jenë ose janë të dyshimta që përdoren për të kryer një kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 6 INFORMATAT NË LIDHJE ME KUNDËRVAJTJET DOGANORE

1. Administrata Doganore e njërës Palë Kontraktuese duhet, me vetë iniciativë ose në kerkeese, brenda kornizës së legjislacionit kombëtar dhe kompetencave e aftësive të tyre, të furnizojnë Administratën Doganore të Palës tjetër Kontraktuese me të gjitha informacionet e mundshme mbi aktivitetet e zbuluara ose të planifikuara, të cilat përbëjnë ose duket të përbëjnë një kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e Shtetit të asaj Pale Kontraktuese.
2. Dosjet origjinale dhe dokumentet duhet të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet e çertifikuara nuk mjaftojnë. Origjinalet, të cilat transmetohen, duhet të kthehen pa u vonuar posa që arsyeja për të cilën ato janë siguruar nga Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese të pushoj së ekzistuari.
3. Të gjitha informatat për interpretim ose përdorim të dokumenteve relevante duhet të sigurohen kohë pas kohe.
4. Përdorimi i informatave elektronike si prova duhet të përcaktohet në pajtim me legjislacionin kombëtar të Palëve Kontraktuese.

Neni 7 DËRGIMI I DOKUMENTEVE

1. Në kërkesë të Administratës Doganore kërkuese Administratat Doganore e kërkuar duhet, në pajtim me legjislacionit e vetë kombëtar të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të dërgoj çdo dokument ose të njoftoj mbi çdo vendim që kanë prejardhje nga Administratat kërkuese dhe që bien brenda fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje, tek një i adresuar që jeton ose është i vendosur në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Kërkesat për dërgime të dokumenteve ose njoftimeve mbi vendimet duhet të bëhen me shkrim në gjuhën zyrtare të Shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar ose në gjuhën e pranuar nga Administrata e kërkuar. Përveç kësaj, përmbajtja e dokumentit zyrtar që duhet të dërgohet duhet të shoqërohet me përkthim të vërtetuar në gjuhën zyrtare të Shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar ose në gjuhën Angleze ose një gjuhë të pranueshme nga Administrata e kërkuar.
3. Një dërgim i tillë duhet të regjistrohet me pranimin nga i adresuari që mban datën e dërgimit ose përmes një çertifikate e cila përshkruan mënyrën e datën e dorëzimit.

Neni 8 DËRGESA I KONTROLLUAR

1. Palët Kontraktuese duhet të marrin masat e nevojshme, brenda kornizës së legjislacionit kombëtar dhe kompetencave e aftësive të tyre për lejuar përdorimin e duhur të dërgesës së kontrolluar me qëllim të hetimeve kriminale.
2. Administratat Doganore munden, përmes miratimit reciprok dhe brenda kompetencave të tyre të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar, të përdorin dërgesën e kontrolluar të mallrave në rast të kundërvajtjes doganore në mënyrë të identifikimit dhe zbulimit të personave të përfshirë.
3. Vendimet për të përdorur dërgesën e kontrolluar duhet gjithnjë të bëhen në bazë të rasteve.
4. Ngarkesat ilegale dërgesa e kontrolluar e të cilave është dakorduar, përmes miratimit reciprok të autoriteteve kompetente, të ndërpriten dhe të lejohen të vazhdojnë me narkotikët ose substancat psokitropike ose mallrat tjera sipas miratimit nga Administratat Doganore të paprekura ose larguar ose zëvendësuar në tërësi ose pjesërisht.

Neni 9 EKZEKUTIMI I KËRKESËS

1. Administrata Doganore e kërkuar duhet të marrë të gjitha masat e arsyshme për të ekzekutuar kërkesën dhe nëse kërkohet për të inicuar ndonjë masë të nevojshme zyrtare ose gjyqësore për të përformuar kërkesën. Administrata

- Doganore e kërkuar duhet të veprojnë brenda kufijve të kompetencave të veta dhe burimeve të gatshme, sikur të jetë duke vepruar për llogari të veten.
2. Administrata Doganore e çdonjërës Palë Kontraktuese duhet, në kërkesë të Administratës Doganore të Palës tjetër Kontraktuese, të kryej hetime të nevojshme, përfshirë edhe marrjen në pyetje nga ekspertët të dëshmitarëve ose personave të dyshimt të kenë kryer kundërvajtje doganore, dhe të ndërmarrin hetime mbi verifikimin, inspektimin dhe gjetjen e fakteve në lidhje me çështjet që referohen në këtë Marrëveshje.
 3. Administrata e kërkuar mund të lejoj caktimin e zyrtarëve të Administratës kërkuese për të qenë prezent në territorin e Shtetit të Palës së kërkuar Kontraktuese, kur zyrtarët e saj janë duke kryer hetime në interes të Administratës, përfshirë edhe prezencën në ato hetime. Zyrtarët e caktuar duhet të jenë prezent vetëm në pikëpamje të këshillëtarëve dhe nuk mund të ushtrojnë autoritetin e akorduar mbi zyrtarët nga Administrata e kërkuar nga legjislacioni i tyre kombëtar. Ata, megjithatë, duhet që vetëm me qëllim të hetimeve që kryhen të jenë prezent dhe përmes zyrtarëve të Administratës së kërkuar, të kenë qasje në objektet dhe dokumentet e njëjta të atyre zyrtarëve të Administratës së kërkuar.
 4. Zyrtarët e Administratës kërkuese Doganore, të autorizuar për hetime të kundërvajtjeve doganore, mund të kërkojnë që zyrtarët e Administratës së kërkuar të inspektojnë librat relevant, regjistrat dhe dokumentet tjera ose të dhënat – mediat dhe të sigurojnë me kopje të tyre ose të sigurojnë informacione në lidhje me ato kundërvajtje.
 5. Kur përfaqësuesit e Administratës Doganore të njëjës Palë Kontraktuese janë të pranishëm në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, sipas kësaj Marrëveshjeje, ata duhet gjatë gjithë kohës të jenë në gjendje të vërtetojnë kapacitetin e tyre zyrtar. Ata nuk duhet të kenë uniformë e as të bartin armë.
 6. Zyrtarët, gjersa janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, duhet të jenë përgjegjës për çdo shkelje që kryejnë, dhe duhet të gëzojnë të drejtën për mbrojtje të siguruar nga dispozitat ligjore dhe administrative të Palës siç është miratuar për zyrtarët Doganor të saj.
 7. Administrata Doganore kërkuese duhet, nëse ashtu kërkohet, të këshillohet mbi kohën dhe vendin e veprimit që ndërmirret për t'iu përgjigjur kërkesës kështu që një veprim i tillë të mund të koordinohet.

8. Në rast se Administrata Doganore nuk është autoriteti kompetent për të përmbushur këtë kërkesë, duhet që pas konsultimit të dërgoj kërkesën pa u vonuar tek autoriteti i duhur, i cili pastaj duhet të veproj sipas fuqive të tij bazuar në legjislacionin kombëtar, ose duhet t'i ofroj Administratës Doganore kërkuese procedurën e duhur që duhet të ndiqet në lidhje me një kërkesë të tillë.

Neni 10 EKSPERTËT DHE DËSHMITARËT

1. Pas kërkesës, zyrtarët e Palës Kontraktuese së kërkuar mund të autorizohen që të paraqiten brenda kufijve të autorizimit të dhënë si ekspert ose dëshmitarë në seancat gjyqësore ose administrative në lidhje me çështjet që mbulohen nga kjo Marrëveshje në territorin e Palës Kontaktuese kërkuese dhe të përgatit dosje, vepra dhe dokumente tjera ose kopje të vërtetuara të këtyre të fundit që nevojiten në seanca. Zyrtarët e tillë duhet të japin prova në lidhje me faktet e krijuara nga ata gjatë kryerjes së detyrave të tyre.
2. Kërkesa për paraqitje duhet të qartë të tregoj llojin e seancës e poashtu edhe statusin në të cilin zyrtari është i thirrur të dëshmoj.

Neni 11 FSHEHTËSIA DHE PËRDORIMI I INFORMACIONIT

1. Çdo informatë e komunikuar në çfarëdo forme sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë e natyrës së fshehtë. Duhet të sigurohet nga obligimi i fshehtësisë zyrtare dhe duhet të gëzoj mbrojtjen sikur për informacionet e të njëjtës natyrë që janë nën legjislacionin kombëtar në fuqi në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese që e pranon atë.
2. Atëherë kur të dhënat personale shkëmbehen sipas kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë një mbrojtje standarde të të dhënave të paktën në ekuivalencë me atë që rezultohet nga implementimi i parimeve që cekën në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje, e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes.
3. Çdo informatë që pranohet sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të përdoret vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje përfshirë edhe përdorimin për

seanca gjyqësore ose administrative në lidhje me kundërvajtjet përkatëse doganore.

4. Informacioni pranuar nuk duhet të përdoret për qëllime tjera përveç atyre që janë specifikuar në këtë Marrëveshje, pa pëlqimin me shkrim nga Administrata Doganore, e cila e ka siguruar atë. Këto dispozita nuk janë të zbatueshme për informacionet në lidhje me qëllimet tjera përveç atyre të specikuara në këtë Marrëveshje, pa pëlqimin me shkrim nga Administrata Doganore e cila e ka siguruar atë. Këto dispozita nuk zbatohen për ato informacione në lidhje me kundërvajtjet me narkotikë, substanca psikotropike dhe pararendës. Informatat e tilla mundën drejtëpërdrejtë të komunikohen tek autoritetet tjera shtetërore të përfshira në luftimin e trafikimit të jashtëligjshëm të narkotikëve.
5. Për më tepër, për shkak të obligimeve që dalin nga Republika e Austrisë si Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian, dispozitat që referohen në paragrafin 4 nuk e përshjashtojnë që informatat e pranuar mundën, nëse është e nevojshme, t'i transportohen Komisionit Evropian dhe Shteteve tjera Anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 12 FORMA DHE PËRMBAJTJA E KËRKESËS PËR NDIHMË

1. Kërkesat sipas Marrëveshjes së tanishme duhet të jenë me shkrim. Dokumentet e nevojshme për të ekzekutuar një kërkesë të tillë duhet të shoqërojnë atë. Atëherë kur kërkohet për shkak të situatës urgjente, kërkesat me gojë mund të pranohen, por ato duhet më vonë të konfirmohen me shkrim pa u vonuar.
2. Kërkesat sipas paragrafit 1 të këtij Neni duhet të përfshijnë informatat në vijim:
 - a) Administratën kërkuese,
 - b) Veprimin e kërkuar,
 - c) Objektivin dhe arsyen e kërkesës,
 - d) Dispozitat ligjore dhe administrative të përfshira,
 - e) Të dhënat sa më të sakta dhe gjithëpërfshirëse që është e mundur mbi personat fizik ose juridik që janë qëllim i hetimeve.
3. Kërkesat duhet të dorëzohen në gjuhën Angleze ose në gjuhën zyrtare të Palës Kontraktuese kërkuese.

4. Administratat Doganore duhet të informojnë njëra tjetrën mbi kontaktet e vetme ku kërkesat duhet të dërgohen.

Neni 13 **SHKARKIMET NGA OBLIGIMI PËR TË DHËNË NDIHMË**

1. Nëse Administrata Doganore e kërkuar konsideron që ndihma e kërkuar mund të shkel mbi sovrenitetin, rendin publik, sigurinë ose ndonjë interes të rëndësishëm kombëtar të Shtetit të Palës Kontraktuese së kërkuar ose do të përfshinte shkelje të ndonjë fshehtësie tregtarë ose profesionale e poashtu edhe zyrtare në territorin e Shtetit të asaj Pale Kontraktuese, ajo mund të refuzoj dhënjen e një ndihme të tillë, ta jap atë pjesërisht ose bazuar në kushte ose kërkesa specifike.
2. Nëse kërkesa për ndihmë nuk mund të përmbushet, Administrata Doganore kërkuese duhet të njoftohet pa u vonuar sa më parë dhe duhet të informohet mbi arsyet për refuzimin e një kërkesë të tillë për ndihmë.
3. Ndhima mund të shtyhet nga Administrata Doganore e kërkuar mbi ato baza që do të mund të bie ndesh me hetimet në vazhdim, ndjekjen penale ose seancat gjyqësore. Në një rast të tillë, Administrata Doganore e kërkuar duhet të konsultohet më Administratën Doganore kërkuese për të përcaktuar nëse ndihma mund të jepet duke iu varur në ato kushte siç mund të specifikohen nga Administrata Doganore e kërkuar. Atëherë kur ndihma shtyhet, duhet të jepen arsyet për këtë shtyrje.
4. Kur Administratë Doganore kërkuese kërkon ndihmë e cila vetë nuk do të kishte mundësi ta ofronte nëse kërkohet nga Administrata Doganore e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, duhet të ketë vëmendje në faktin e asaj kërkesë. Atëherë duhet t'i dorëzohet Administratës Doganore të kërkuar për të vendosur se si do të reagoj në një kërkesë të tillë.

Neni 14 **SHPENZIMET**

1. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese nuk duhet të kërkojnë kompensim të shpenzimeve të shkaktuara gjatë ekzekutimit të kësaj

Marrëveshjeje, në përjashtim të shpenzimeve për ekspertët, dëshmitarët, përkthyesit përveç punëtorëve tjerë të Shtetit.

2. Nëse shpenzimet e një natyre të konsiderueshme dhe të jashtëzakonshme janë ose do të kërkohen për të ekzekutuar kërkesën, Palët Kontraktuese duhet të konsultohen për të përcaktuar kushtet nën të cilat kërkesa do të ekzekutohet e poashtu edhe mënyrën sipas të cilës shpenzimet do të lindin.

Neni 15 IMPLEMENTIMI

1. Implementimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të vihet në dorëzim drejtëpërdrejtë Administratave Doganore të Palëve Kontraktuese. Këto Administrata Doganore duhet në mënyrë reciproke të bien dakord mbi rregullimet e detajuara për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët Kontraktuese pajtohen që Administratat Doganore mund të komunikojnë drejtëpërdrejtë për arsye të marrjes me çështjet që dalin nga kjo Marrëveshje ose ndonjë çështje tjetër doganore e cila mund të jetë me interes të përbashkët.
3. Administratat Doganore bazuar në miratim reciprok marrin përsipër zgjidhjen e problemve ose dyshimeve që mund të dalin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Kjo nuk përjashton rregullimin e diskutimeve të tilla përmes mjeteve diplomatike.
4. Marrëveshje e tanishme nuk ndikon në ndonjë obligim që del nga anëtarësimi i Republikës së Austrisë në Bashkimin Evropian. Si pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të mos thirren ose interpretohen në atë mënyrë që do të mund të ndikonte ose të shfuqizonte obligimet që dalin nga Traktati për Bashkimin Evropian ose Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian ose marrëveshjeve të nënshkruara në mes të Republikës Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 16 PËRMIRËSIMET

Përmirësimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me iniciativë të cilësdo nga Palët Kontraktuese, e cila duhet të hartohet me Protokolle të ndara. Këto Protokolle duhet të hyjnë në fuqi në pajtim me procedurat e

parashikuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe duhet të jenë pjesë përbërëse të saj.

Neni 17
HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë në vijim të datës së pranimit të njoftimit të fundit përmes të cilit Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra tjetrën përmes kanaleve diplomatike në lidhje me procedurat e brendshme të cilat janë përmbushur për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje është e konkluruar për një periudhë të pacaktuar kohore. Cilado Palë Kontraktuese mund të në çdo kohë të përfundoj këtë Marrëveshje me njoftim përmes kanaleve diplomatike të Palës tjetër Kontraktuese. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të filloj pas gjashtë muajve pas pranimit të një njoftimi të tillë nga Pala tjetër Kontraktuese.
3. Diskutimet në vazhdim gjatë kohës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje duhet megjithatë të përfundohen në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

E bërë më 14.09.2012 në Vjenë në dy origjinale, të dyja në gjuhën Gjermane, Shqipe dhe Angleze, të gjitha tekstet janë njëjtë autentike.

Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim të dispozitave në këtë Marrëveshje, teksti në Gj. Angleze do të mbizotëroj.

Për Qeverinë
e Republikës së Austrisë

Andreas Schieder m.p.

Për Qeverinë
e Republikës së Kosovës

Naim Huruglica m.p.

ANEKSI**PARIMET BAZË TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE**

1. Administrata e cila komunikon të dhëna duhet të siguroj që ato janë të sakta dhe të datës duhur.
2. Nëse del në shesh se të dhëna të pasakta janë komunikuar ose janë komunikuar të dhëna që nuk është dashur të komunikohen ose që të dhënat e ligjshme kërkohet në një fazë më vonë të fshihen në pajtim me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese komunikuese, Administrata pranuese duhet të informohet mbi këtë menjëherë. Duhet të obligohet që të korrigjoj të dhënat e tilla ose t'i fshij ato.
3. Nëse Administrata pranuese ka arsye për të besuar që të dhënat e komunikuar janë të pasakta ose duhet të fshihen, ajo duhet menjëherë të informoj Palën Kontraktuese komunikuese.
4. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që të dhënat personale komunikohen vetëm përmes medieve komunikuese, të cilat ofrojnë një nivel të duhur të mbrojtjes ndaj njohurisë ose modifikimit të të dhënave në fjalë gjatë komunikimit.
5. Të dyja, pra Administrata komunikuese dhe ajo pranuese duhet të obligohen që në mënyrë efektive të mbrojnë të dhënat personale të pranuar ndaj shkatërrimit aksidental ose të paautorizuar, humbjes aksidentale, qasjes së paautorizuar, modifikimit të paautorizuar ose aksidental ose shpërndarjes së paautorizuar.
6. Të dyja, pra Administrata komunikuese dhe ajo pranuese duhet të obligohen që të regjistrojnë qëllimin, lëndën dhe kohën e komunikimit të të dhënave personale e poashtu edhe Administratën komunikuese dhe Administratën pranuese. Të dhënat e dokumentuara duhet të ruhen për të paktën tri vite dhe mund të përdoren vetëm për qëllim të sigurimit të mbikqyrjes së përmbushjes së dispozitave të zbatueshme mbi mbrojtjen e të dhënave.
7. Kontrolluesi përgjegjës për të ndërmarrë masat e duhura për të mbrojtur të dhënat e dokumentuara ndaj përdorimit për ndonjë qëllim tjetër ose ndonjë keqpërdorim.
8. Sipas legjislacionit kombëtar të dhënat e komunikuar duhet të mbahen në databazë për në periudhë që nuk i tejkalon nevojat e qëllimeve për të cilat ato janë komunikuar.

9. Të dhënat personale të komunikuar duhet të fshihen, nëse gjenden të jenë të pasakta, ose që janë marrë ose komunikuar në mënyrë të paligjshme, ose nëse të dhënat e komunikuar të ligjshme duhet të fshihen në një datë me vonë sipas dispozitave ligjore të Palës komunikuese, ose nëse të dhënat më nuk janë të nevojshme për përmbushjen e detyrës së deklaruar nga Administrata aplikuese.
10. Kontrollouesi duhet të ofroj lëndën e çdo të dhëne, i cili e vërteton identitetin e tij në mënyrën e duhur, me informacione për të dhënat që duhet të përpunohen në lidhje me të, informatat e duhura për origjinën e tyre, pranuesit ose kategoritë e pranuesve të transmetimit, qëllimin e përdorimit të të dhënave e poashtu edhe bazat ligjore në një formë të kuptueshme. Informatat duhet të jepen pa ndonjë vonesë të tepruar dhe sipas parimit pa pagesë.
11. Gjithashtu subjekti i të dhënave duhet të ketë të drejtën e korrigjimit të të dhënave të pasakta ose jo të plota dhe të fshirjes së të dhënave të përpunuara ilegalisht. Detaje tjera procedurale në lidhje me zbatimin e këtyre të drejtave duhet të trajtohen brenda legjislacionit kombëtar.
12. Administrata e njëjës Palë Kontraktuese që pranon të dhëna personale sipas kësaj marrëveshjeje mund të mos deklaroj që Administrata e Palës tjetër Kontraktuese ka komunikuar të dhëna të pasakta ose ka komunikuar të dhëna të paligjshme në mënyrë që të evitoj përgjegjësinë e vetë sipas legjislacionit kombëtar në lidhje me Palën e dëmtuar.
13. Nëse Pala pranuese dhuron kompenesim për dëmin e shkaktuar gjatë përdorimit të të dhënave personale të komunikuar jo saktë atëherë Pala komunikuese duhet të detyrohet të kompensoj, sipas kërkesës, shumën e përgjithshme të paguar si kompensim.